AVOKATI I POPULLIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax:+355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K1/H6 -7 Prot. **Tiranë 08/11/2022**
Nr. Dok. 202201060/7

Lënda: *Sugjerojmë marrjen e masave për vlerësimin e kushteve social-ekonomike, ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për familjes Ç. për zgjidhjen e problematikës lidhur me strehimin.*

BASHKISË KËLCYRË

PËRMET

Të nderuar,

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur një ankesë shtetasi H. K., Këlcyrë, Përmet.

Objekt i kësaj ankese është vështirësitë ekonomike me të cilat po përballet familja Ç.

Familja e L. Ç. ka dy fëmijë, të cilët janë të vlërësuar me paaftësi të grupit të parë, me diagnozë distrofi muskulare. I jati i fëmijëve L. Ç. është larguar dhe familja nuk ka dijeni ku. Ankuesi, z. H. K. është daja i fëmijëve,

Të ndodhur në këto kushte, ankuesi ka kërkuar ndihmën e Avokatit të Popullit, i cili në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore si dhe në respektim të detyrimeve ligjore që rrjedhin në zbatim të Kushtetutës dhe të ligjit, për garantimin e të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve, që veprojnë për llogari të saj, ka marrë në shqyrtim këtë ankesë duke ju drejtuar në mënyrë shkresore DRSHSSH Gjirokastër dhe Insitucionit tuaj, duke ju kërkuar informacion për trajtimin e problematikës që paraqet shtetasi Hartjen Karati në ankesën e tij, sipas legjislacionit në fuqi.

Siç ju kemi bërë me dije, sa na ka informuar Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Gjirokastër në përgjigjen e saj me shkrësën 2051/1 Prot, datë 20.09.2022, fëmijët V. dhe K. Ç. trajtohen me pagesë paaftësie respektivisht:

Fëmija V. Ç. trajtohet si person i paaftë, grupi i dytë (pa shoqërues) me vendim të KMCAP, niveli i parë Paraplegji-Tetraplegji/ Neurologji, Tiranë, nr. 2337, datë 26.04.2022, me afat përfitimi nga 01.03.2022 deri 01.03.2022, me pagesë 11,084 (njëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë.

Fëmija K. Ç. trajtohet si person i paaftë, grupi i parë (me shoqërues) me vendim të KMCAP, niveli i parë Paraplegji-Tetraplegji/ Neurologji, Tiranë, nr. 2330, datë 26.04.2022, me afat përfitimi nga 01.02.2022 deri 01.02.2022, me pagesë 11,084 (njëmbëdhjetë mijë e tetëdhjetë e katër) lekë. Bazuar në VKM nr.182, datë 26.02.2020 *"Për përcaktimin e masës, të kritereve, proçedurave dhe dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuar, si dhe ndihmësit personal",* fëmija K. Ç. përfiton një ndihmës personal me pagesë 11,084 (njëmbëdhjetë mijë e tetedhjetë e katër) lekë për kujdestarin.

Në total pagesat për këtë familje janë 33 252 (tridhjetë e tre mijë e dyqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Bashkisë Këlcyrë duke kërkuar në mënyrë të përsëritur informacion për zgjidhjen e problematikës së strehimit së familjes Çurri, me shkresat nr. K1/H6-2, datë 13.09.2022 dhe nr.K1/H6-6, datë 10.10.2022, por në kundërshtim të pikës 4, të nenit 63, të Kushtetutës, ku: "organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t'i paraqesin Avokatit të Popullit të gjithë dokumentacionin dhe informacionet e kërkuara prej tij", instucionin juaj nuk na ka dhënë asnjë informacion për vlerësimin e situatës ekonomike sociale të kësaj familjeje dhe as për masat e marra nga ana e Bashkisë për ndihmën që mund t'i ofrohet nga shteti, sa parashikohet në ligjin Nr.22/2018 " Për strehimin social".

Për sa më sipër:

Sugjerojmë marrjen e masave për vlerësimin e kushteve social-ekonomike, ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për familjes Ç, për zgjidhjen e problematikës lidhur me strehimin, sipas legjislacionit në fuqi, duke ***vlerësuar interesin më të lartë të fëmijëve në këtë familje.***

Lutemi dërgimin e një përgjigjeje lidhur me trajtimin e rastit dhe sugjerimit, brenda një afati 10 ditor, nga marrja dijeni e kësaj shkrese.

Duke Ju falënderuar për mirëkuptimin dhe, në vijim të bashkëpunimit midis institucioneve tona, në funksion të përmbushjes së detyrimeve kushtetuese dhe ligjore, për garantimin me efektivitet të ushtrimit, respektimit dhe mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

K O M I S I O N E R

VILMA SHURDHA
DV